



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1087/Prot.

Tiranë, më 10 /11/2015

VENDIM

Nr. 50, datë 10/11/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Z. _____, i përfaqësuar me prokurë të posaçme dt. 19.08.2015 nga Av. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 1087 Prot., datë 23.10.2015, ndaj Autoritetit Publik/ Autoritetit Rrugor Shqiptar, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare*".

Ankuesi në cilësinë e kërkuesit, me shkresën e datës 05.09.2015 ka kërkuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar të informohet dhe të marrë kopje të vërtetuar të dokumentave zyrtare lidhur me *procedurën e miratimit të kryerjes së punimeve shtesë në rrugën Rrëshen- Kalimash në vendin e quajtur Ndërfushas, Mirditë, menjëherë pas mbikalimit të diktuar nga rrëshqitjet e tokës si dhe dokumentacionin teknik të kryerjes së këtyre punimeve*.

Ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar lidhur me sa ka kërkuar dhe për këtë arsye ka depozituar ankim pranë Zyrës së Komisionerit. Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri pas vlerësimit të ankesës së Z. _____, me Urdhrin nr. 217 datë 30.10.2015, urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/ Autoritetit Rrugor Shqiptar, me qëllim verifikimin e këtyre fakteve. Pranë Autoritetit Publik u depozitua Urdhri i inspektimit administrativ dhe u protokollua me nr. 8910 Prot., datë 30.10.2015. Nga ana e grupit të inspektimit u konstatua së kërkesa e Z. _____, drejtuar ARRSH-së, është depozituar pranë këtij institucioni dhe është regjistrua me nr. 7295 Prot., datë 08.09.2015.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Koordinatorja e ARRSH-së, u konstatua se të njëjtën kërkesë të datës 05.09.2015, Z. _____ e ka dërguar edhe në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës. Me anë të shkresës nr. 4588/1 Prot., datë 18.09.2015, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës e ka dërguar për ndjekje tek Autoriteti Rrugor Shqiptar. Pas delegimit të kërkesës së Z. _____ nga ana e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës tek Autoriteti Rrugor Shqiptar, ky i fundit me anë të shkresës nr. 7788/1 Prot., datë 20.10.2015 i ka kthyer përgjigje Z. _____ duke vënë në dijeni avokatin e tij si dhe Sekretarin e Përgjithshëm të MTI-së, duke sqaruar se: "*nga ana e ARRSH-së për të gjitha pasuritë që nuk kanë dalë në VKM-të e mëparshme jemi duke ndjekur procedurat e shpronësimit, për përgatitjen e materialit shtesë dhe përcjelljen e tij pranë MTI-së*".

Në përgjigjen e dhënë nga ARRSH-ja, kërkuesit nuk i është vënë në dispozicion kopja e dokumentacionit të kërkuar, si dhe nuk i janë bërë sqarimet përkatëse nëse ky dokumentacion

mund të lëshohet ose jo nga ana e autoritetit publik. Pas inspektimit të kryer, me shkresën nr.8910/1 Prot.,datë 05.11.2015 Autoriteti Rrugor Shqiptar i drejtohet Z. Pashk Përloshi duke vënë në dijeni edhe Zyrën e Komisionerit "se nga ana e ARRSH-së po vijohet për përgatitjen e kërkesës për shpronësim (shitesë), për të gjitha pasuritë që nuk janë përfshirë në VKM-në e mëparshme për shpronësim, pjesë e të cilës është edhe pasuria juaj, në zbatim të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet për interes publik..."

Edhe pse Autoriteti Publik/ Autoriteti Rrugor Shqiptar ka reaguar duke kthyer përgjigje pas kryerjes së inspektimit administrativ, kërkesit nuk i është vënë në dispozicion kopje e vërtetuar e dokumentave zyrtare lidhur me procedurën e miratimit të kryerjes së punimeve shitesë në rrugën Rrëshen- Kalimash në vendin e quajtur Ndërfushas, Mirditë, menjëherë pas mbikalimit të diktuar nga rrëshqitjet e tokës si dhe dokumentacionin teknik të kryerjes së këtyre punimeve .

Bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", autoriteti publik trajton kërkesën për informim brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të saj. Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës brenda këtij afati konsiderohet refuzim dhe bazuar në nenin 18, pika 2 a) e ligjit përbën shkelje administrative.

Nga dokumentacioni i administruar vërehet se, kërkesa nuk është trajtuar brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 15 pika 1 e ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit, në të cilin thuhet: "Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe".

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Z. kundër Autoritetit Publik/ Autoritetit Rrugor Shqiptar, Komisioneri vlerëson se, ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Z. Nr. 1087 Prot., datë 23.10.2015, kundër Autoritetit Publik/ Autoritetit Rrugor Shqiptar, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Autoritetit Rrugor Shqiptar, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (kopje të vërtetuar të dokumentave zyrtare lidhur me procedurën e miratimit të kryerjes së punimeve shitesë në rrugën Rrëshen- Kalimash në vendin e quajtur Ndërfushas, Mirditë, menjëherë pas mbikalimit të diktuar nga rrëshqitjet e tokës si dhe dokumentacionin teknik të kryerjes së këtyre punimeve), brenda datës 20.11.2015.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 10.11.2015.

